



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Ekonominë dhe
Financat

Tiranë, më 18.6.2019

Dokument parlamentar

R A P O R T

**PËR PROJEKTLIGJIN “PËR DISA SHTESA NË AKTIN NORMATIV, ME FUQINË E
LIGJIT, NR.4, DATË 9.7.2008, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
PRIVATIZIMIN DHE DHËNIEN NË PËRDORIM SHOQËRIVE TREGTARE DHE
INSTITUCIONEVE SHTETËRORE TË NDËRMARRJEVE APO OBJEKTEVE TË
VEÇANTA, MJETEVE KRYESORE DHE MJETEVE TË XHIROS SË KËTYRE
NDËRMARRJEVE””, MIRATUAR ME LIGJIN NR.9967, DATË 24.7.2008, DHE
NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.3/2015**

• ***Hyrje.***

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 18 qershor 2019, shqyrtoi projektligjin “Për disa shtesa në aktin normativ, me fuqinë e ligjit, nr.4, datë 9.7.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për privatizimin dhe dhënie në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve””, miratuar me ligjin nr.9967, datë 24.7.2008 dhe ndryshuar me ligjin nr.3/2015.

Projektligji është propozuar nga Këshilli i Ministrave. Komisioni për Ekonominë dhe Financat e shqyrton këtë projektligj përputhje me procedurat e parashikuara në nenet 32-39 të Rregullores së Kuvendit.

Komisioni caktoi relatore për këtë projektligj znj. Evis Kushi.

Në mbledhje ishin të pranishëm, për të paraqitur projektligjin dhe për të dhënë informacionet e kërkuara nga deputetët, Zëvendësministri i Financave dhe Ekonomisë dhe përfaqësues të tjerë të kësaj ministrie.

- ***Baza kushtetuese e projektligjit.***

Këshilli i Ministrave e paraqiti projektligjin bazuar në nenet 81, pika 1 dhe 100 të Kushtetutës. Miratimi i këtij projektligji kërkon një shumicë të thjeshtë votash, sipas nenit 55, pika 1 të Rregullores së Kuvendit.

- ***Qëllimi, përmbajtja dhe risitë e projektligjit.***

Qëllimi i projektligjit është zgjerimi i konceptit të privatizimit të pronës shtetërore, në funksion të zbatimit të planeve të zhvillimit urban të njësive të vetëqeverisjes vendore.

Në praktikën e deritanishme janë ndeshur raste kur planet e zhvillimit urban të njësive të vetëqeverisjes vendore parashikojnë kryerjen e investimeve në sipërfaqe toke që janë kryesisht në pronësi private, por përfshijnë edhe një sipërfaqe të vogël prone shtetërore. Sipërfaqja e tokës në pronësi private rrethon, prek apo kufizohet me sipërfaqe toke në pronësi të qeverisjes qendrore ose njësive të vetëqeverisjes vendore. Sipërfaqja e tokës shtetërore nuk tejkalon 20 për qind të totalit të sipërfaqes (private plus shtetërore).

Gjithashtu, janë hasur edhe paqartësi në regjimin juridik të tokës, i cili ndryshon në varësi të llojit dhe mënyrës së përdorimit të saj (tokë truall, tokë bujqësore, pyje, kullota, livadhe, toka të pafrytshme). Ndër vite, disa sipërfaqe toke i kanë humbur funksionet për të cilat janë përdorur më parë. Si rrjedhojë, janë krijuar problematika në drejtim të sigurisë juridike që lidhet me pronat.

Ekzistenca e këtyre pronave shtetërore dhe paqartësitë në regjimin juridik të tyre kanë krijuar pengesa për kryerjen e investimeve dhe zbatimin e planeve të zhvillimit urban të vetëqeverisjes vendore.

Aktualisht, kuadri ligjor parashikon dy forma të privatizimit të pronës shtetërore: shitjen me ankand dhe tenderin. Për t'i dhënë më shumë kuptim, hapësirë dhe fleksibilitet procesit të privatizimit, projektligji parashikon që krahas këtyre dy formave, të shtohet edhe një formë tjetër e privatizimit të pronës shtetërore, që është “tjetërsimi”. Tjetërsimi do të bëhet sipas kontratave që do të lidhen me blerësin e pasurisë shtetërore. Projektligji parashikon që privatizimi i pronës shtetërore të bëhet edhe në funksion të planeve të përgjithshme vendore. Detajet për kryerjen e procesit të privatizimit, siç janë kushtet që duhet të plotësojnë kërkuesit e tjetërsimit me kontratë të pronës shtetërore, mënyra e vlerësimit të kësaj prone, organet që do të kryejnë këtë proces dhe roli i tyre do të përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

Ndryshimet e propozuara me këtë projektligj do të ndihmojnë në zgjidhjen e disa problematikave, që ndeshen aktualisht, me disa sipërfaqe toke shtetërore, të cilat preken nga planet e përgjithshme vendore. Vënia në zbatim e tyre do të ndikojë në lehtësimin e procesit të privatizimit të pronës shtetërore, rritjen e investimeve vendase e të huaja dhe përmirësimin e zhvillimit territorial të vendit tonë.

- ***Diskutimi në Komision.***

Relatorja paraqiti projektligjin dhe vuri theksin në rolin që ai do të luajë në zbatimin e planeve të zhvillimit urban të njësive të vetëqeverisjes vendore.

Zëvendësministri i Financave parashtroi nevojën dhe thelbin e projektligjit, si dhe iu përgjigj pyetjeve të deputetëve.

Gjatë diskutimit deputetët e vlerësuan të nevojshëm projektligjin, për të krijuar më shumë hapësirë për zbatimin e planeve të zhvillimit urban të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe për të mbështetur rritjen e investimeve. Komisioni u ndal në këto çështje kryesore:

Së pari, dhënien në projektligj të një koncepti më të qartë për tjetërsimin e pronës shtetërore;

Së dyti, vendosjen në projektligj të një kufiri të pronës shtetërore që do të privatizohet sipas kërkesave të këtij ligji.

- ***Përfundim.***

Mbështetur në argumentet e mësipërme, Komisioni e miratoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi me shumicë votash, duke i propozuar seancës plenare ndryshimet si më poshtë:

Në nenin 1 bëhen këto ndryshime:

Në fund të pikës 1, pas fjalëve “ose tjetërsimit” shtohen fjalët “sipas veprimeve juridike të kalimit të pronësisë së pasurive të paluajtshme, të përcaktuara në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, përveç formës së kalimit të pronësisë nëpërmjet kontratës së dhurimit.”.

Në paragrafin e fundit, fjalia e parë riformulohet si më poshtë:

“Kalimi i pronës shtetërore në private bëhet edhe në funksion të planeve të përgjithshme vendore, me kushtin që pjesa shtetërore të mos jetë më e madhe se 20 për qind e pronës që do të zhvillohet, sipas kushteve dhe kriterëve që përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

RELATORJA

Evis KUSHI

KRYETARI

Arben AHMETAJ